

## INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 17.10.2024

### TË DHËNA JAVORE

Në periudhën 11-17.10.2024 janë regjistruar gjithsej 7 raste të reja me pertusis, 2 më pak se javën që shkoi (n=9).

Numri më i madh i tyre (n=5; 55,6%) janë raportuar në Shkup (n=5; 71,4%) dhe nga 1 në Prilep dhe Gostivar. (Tabela 1)

Mosha e të prekurve sillet nga 1 muaj deri në 3 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës nga 0-4 vjet.

Sa i përket statusit të vaksinimit, 5 persona nuk janë të vaksinuar me të gjitha dozat e vaksinës, nuk janë të vaksinuar ose nuk ka të dhëna për statusin e tyre të vaksinimit, ndërsa 2 prej tyre janë të vaksinuar në përputhje me moshën.

Nga rastet e reja 3(42,9%) raste janë hospitalizuar.

Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me pertusis në RMV, 04-10.10.2024

Qyteti/Komuna	Numri i personave të sëmurë
Shkup	5
Çair	4
Kisella Voda	1
Gostivar	3
Prilep	1

### Të dhëna kumulative

Në vitin 2024, deri me datë 17.10.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 1.138 raste me pertusis, me një incidencë prej 62,0/100,000 banorë. Kjo paraqet një rritje të shumëfishtë të numrit të të sëmurëve krahasuar me periudhën paraprake pesëvjeçare (2019-2023) kur janë regjistruar gjithsej 10 raste.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 807 (70,9%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 2).


Në kuadër të epidemisë në Kumanovë janë regjistruar 116 (10,2%) të sëmurë, ndërsa në kuadër të epidemisë në Tetovë janë regjistruar 65 (5,7%) të sëmurë, ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 20 qytete të tjera.

Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e rasteve me pertusis në RMV (n=1.138), 2024

Qyteti/Komuna	Numri i personave të sëmurë	Qyteti/Komuna	Numri i personave të sëmurë
Shkup	802	Manastir	49
Aerodrom	161	Manastir	48
Karposh	128	Mogilla	1
Çair	106	Prilep	20
Kisella Voda	86	Prilep	12
Qendër	68	Dollnen	7
Gazi Baba	49	Krivogashtani	1
Studenica	42	Kratovë	18
Gjorçe Petrov	41	Kriva Pallankë	14
Butel	37	Gostivar	8
Saraj	27	Gostivar	7
Shuto Orizare	21	Vrapçisht	1
Haraçina	16	Kërçovë	7
Petrovec	9	Strumicë	5
Sopishte	5	Strumicë	4
Ilinden	5	Bosilovë	1
Çuçer Sandevë	4	Veles	4
Zelenikovë	2	Gjevgjeli	4
Kumanovë	116	Koçan	3
Kumanovë	97	Probishtip	3
Likovë	19	Dibër	3
Tetovë	65	Strugë	2
Tetovë	27	Krushevë	2
Zhelinë	15	Kavadar	2
Tearcë	13	Prespë	2
Bogovinjë	4	Ohër	1
Brvenicë	4	Makedonski Brod	1
Jegunovcë	2	Pllasnicë	1
		Demir Hisar	1
		Negotinë	1

Incidencë më e lartë prej 238,6/100.000 është regjistruar në Kratovë dhe në Shkup (132,9/100.000). (Hartogrami)

Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QSHP/NJR, pertusis në RMV, 2024




Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 82 vjet (mesatarja 9,0 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë deri në 4 vjet (36,1%), 243 ose 21,4% i përkasin grupmoshës nën 1 vjet, 168 (14,8%) janë nga 1 deri në 4 vjet.

Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (1.469,6/100.000). (Grafiku 1).

Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 518 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 620 femra.


**Grafiku 1.** Shpërndarja e të sëmurëve me pertusis (n=1.138) sipas moshës, në RMV, 2024



Lakorja epidemike tregon se shfaqja e rasteve të reja të pertusis fillon në javën 50 të vitit 2023. Sipas të dhënave vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rasteve në bazë javore, deri në javën e 11. Nga java 12-25 numri i rasteve të regjistruara bie. Nga java 26 vihet re një rënie e numrit të rasteve të raportuara.

Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve (1.138), tek 1.129 persona janë regjistruar simptoma, ndërsa tek 9 sëmundja ka formë asimptomatike.


**Grafiku 2.** Shpërndarja e të sëmurëve me pertusis (n=1.129) sipas javës së raportimit, në RMV, 2024



Sa i përket statusit të vaksinimit, 719 (63,2%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 419 persona. (Grafiku 3).

**Grafiku 3.** Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=1.138) me pertusis në RMV, 2024



Nga të sëmurët në spital janë shtruar 178 persona (15,6%), ndërsa 155 (87,1%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet. Numri më i madh i rasteve (110; 61,8%) janë shtruar në KU për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët në Kozle. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të shtruar në spital, 175 janë lëshuar si të shëruar. Të sëmurët kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.

Nga numri i përgjithshëm (n=1.138) i rasteve të regjistruara me pertusis, 1.136 janë konfirmuar laboratorikisht, përkatësisht në Avicena (290), Institutin e Shëndetit Publik (220), Biotek (180), QSHP Kumanovë (124), Sinlab (79), Laor (54), Instituti i mikrobiologjisë (44), SK Sistina (39), QSHP Manastir (37), Plodnost Manastir (28), Klinikën Zhan Mitrev (21), SK Manastir (7), Remedika (5), dhe Ramus (5), SP Prilep (2) dhe Ramus Strumicë (1).

**Klasifikimi i rasteve:**

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=1.138) të pertusis, 1.136 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe dy si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator).

Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 173 rastesh.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.


### **Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-17.10.2024**

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit, është konstatuar se janë zbuluar 23.036 fëmijë që e kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 16.899 (73,4%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (7.956; 47,1%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 21.282 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (14.301; 67,2%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-17.10.2024 është 38.181.

**Grafiku 3.** Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024





**Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-17.10.2024**

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik (pa të dhënat nga NJR Kërçovë për javën paraprake), 10.393 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 7.560 (72,7%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (3.418; 45,2%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 31.108 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (18.518; 59,5%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-17.10.2024 është 38.668.

**Grafiku 4.** Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024



## Rekomandime

Për ta parandaluar shfaqjen e rasteve të reja të pertusis dhe për ta parandaluar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes, është e nevojshme:

- Të rritet mbulimi me vaksinim primar me një vaksinë që përmban komponent kundër pertusis që të mund të arrihet niveli i mbulimit të rekomanduar nga OBSH prej 95%, si në nivel rajonal ashtu edhe në atë lokal, si dhe në nivel kombëtar.
- Për këtë qëllim, në të gjitha pikat e vaksinimit në territorin e RMV-së, është e nevojshme të kryhet një inspektim i përforcuar dhe i vazhdueshëm i personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, si dhe të ftohen për aplikim të dozave të nevojshme të vaksinës. Gjithashtu, nevojitet një kërkim aktiv i intensifikuar i personave të paevidentuar, të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht, me qëllim që të ftohen për tu vaksinuar sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.
- Shërbimet epidemiologjike pranë QSHP/NJR në bashkëpunim me ISHSSH të kryejnë kontroll të intensifikuar në pikat e vaksinimit, kontrollin e statusit të vaksinimit të



personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, gjetjen e personave të pavaksinuar dhe të pavaksinuar plotësisht.

- Të përforcohet mbikëqyrja epidemiologjike për pertusis. Çdo rast i dyshuar që i plotëson kriteret klinike të definimit të rastit duhet të hetohet epidemiologjikisht, të testohet në laborator, pra të konfirmohet dhe të raportohet pranë institucioneve kompetente.
- Personat e dyshuar/të sëmurë të dërgohen për diagnostikim laboratorik dhe menjëherë të raportohen pranë institucioneve kompetente.
- Të bëhet izolimi i të sëmurëve në institucione shëndetësore ose në shtëpi, e sidomos nëse në familje ka foshnja, fëmijë të vegjël dhe persona të pavaksinuar, të paktën 5 ditë nga fillimi i terapisë me antibiotikë. E njëjta gjë vlen edhe për pacientët/kontaktet e dyshuara të personave të prekur nëse ata pranojnë kimioprofilaksë.
- Të gjithë mjekët amë duhet ta kontrollojnë statusin e vaksinimit të të gjithë fëmijëve deri në 14 vjet gjatë ekzaminimit dhe t'i udhëzojnë për vaksinim të gjithë fëmijët që e kanë lëshuar ndonjë dozë të vaksinës ose që janë të pavaksinuar;
- QSHP dhe ISHP të kryejnë aktivitete edukative dhe promovuese në lidhje me parandalimin e pertusis, pra theksimin e vaksinimit si masën e vetme parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve.

#### **Vlerësimi i rrezikut:**

Kjo sëmundje në Republikën e Maqedonisë së Veriut është regjistruar me raste sporadike në 20 vitet e fundit (6 mesatarisht).

Rritja e numrit të fëmijëve të pavaksinuar (ulja e mbulimit me imunizimin e detyrueshëm), fushatat kundër vaksinimit, por edhe hezitimi i prindërve në lidhje me imunizimin shkaktojnë rishfaqjen e sëmundjeve të parandalueshme me vakcina në Maqedoni.

Duke marrë parasysh këtë, ekziston mundësia e regjistrimit edhe të rasteve të tjera të reja në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ekziston një rrezik mesatar për popullatën në rajonet me mbulim të ulët me vaksinim, por ai mund të minimizohet duke i ndjekur rekomandimet e institucioneve kompetente.

#### **Përfundime**

- Në vitin 2024 janë regjistruar 1.138 të sëmurë me pertusis.
- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (70,9%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 22 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive ka në territorin e Shkupit, Tetovës dhe Kumanovës.
- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 0-4 vjet (36,1%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 1.469,6/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (1.138), 719 raste (63,2%) nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=297), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 11 vjet.
- Nga 1.138 rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 1.136 raste.

- Nga 18.01-17.10.2024, janë dhënë gjithsej 76.849 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër pertusis.

**Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive  
ISHPRMV**

**18.10.2024**